



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 105, datë 19.10.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.000.000 (TREMILION) LEKË PËR  
OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIMI PARKU URBAN SPITALLË”, NGA FONDI  
REZERVË I BASHKISË DURRËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 3.000.000 (tremilion) lekë për objektin: “Studim projektimi Parku Urban Spitallë”.
2. Efekti financiar sipas pikës 1, do të sigurohet nga fondi rezervë i bashkisë Durrës miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”.




3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.


**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 20.10.2022**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 812 / prot.

Durrës, më 27 / 10 / 2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.105 datë 19.10.2022 :

Për miratimin e përdorimit të fondit prej 3.000.000(tremilion) lekë për objektin “Studim projektim parku urban Spitalë” nga fondi rezervë i Bashkisë Durrës

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
EMILJAN JANI

